



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 17 gusht 2020
Nr. ref.:RK 1604/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI184/19

Parashtrues

Naser Gashi

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës Rev. nr. 220/2019 të 10 korrikut 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Naser Gashi, nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Fehmi Shala, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 220/2019, të 10 korrikut 2019, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 1803/19, të 25 prillit 2019 dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore C. nr. 532/19, të 5 marsit 2019.
3. Vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 22 korrik 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenet 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 10 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 16 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 5 shkurt 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.
9. Më 5 mars 2020, Sekretariati i Gjykatës qarkulloi Projekt-aktvendimin tek të gjithë gjyqtarët për shqyrtim të mëtejme, bazuar në paragrafët 6, 7 dhe 8 të nenit 22 të Ligjit në lidhje me rregullin 38 (3) të Rregullores së punës.
10. Me 12 mars 2020, gjyqtari raportues njoftoi Gjykatën në përbërje të plotë se gjatë procesit të qarkullimit të Aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI184/19, është vënë re që gjatë procedurës së regjistrimit të kërkesës ka ardhur deri te një lëshim teknik-procedural për faktin se Gjykata nuk u ka

dërguar njoftime për regjistrimin e kërkesës parashtuesit të kërkesës dhe palëve të tjera të interesuara.

11. Të njëjtën ditë, më 12 mars 2020, gjyqtarët e Gjykatës njëzëri u pajtuan që duhet të korrigjohet ky lëshim procedural i cili do të mund të ndikonte në pranueshmërinë e kërkesës. Në pajtim me këtë, ata vendosën; i) të tërhiqet nga qarkullimi Projekt-aktvendimit për papranueshmëri në rastin KI184/19, ii) të ndiqet procedura e paraparë ligjore për njoftimin e palëve, dhe t'u jepet atyre mundësia për të paraqitur komente, nëse kanë, në pajtim me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës, iii) që pas eliminimit të të gjitha mangësive procedurale, çështja të shqyrtohet përsëri nga Gjykatë, në mënyrë që të merret vendimi për këtë rast.
12. Më 24 mars 2020, Gjykata njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtuesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
13. Më 24 mars 2020, Gjykata gjithashtu njoftoi lidhur me kërkesën e parashtuar edhe personin V.A., në cilësi të palës së interesuar dhe për faktin se ishte palë në procedurë në gjykatat e rregullta. Gjykata i dha mundësinë që, nëse ka, të dorëzojë komentet lidhur me kërkesën e parashtuar, në një afat prej tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i njoftimit të Gjykatës.
14. Më datat 22 dhe 23 prill 2020, pala e interesuar V. A. parashtroi në Gjykatë komentet lidhur me rastin dhe një numër të caktuar të vendimeve gjyqësore.
15. Më 15 korrik 2020, pasi shqyrtoi mosveprimin tekniko-procedural të theksuar më sipër, Kolegji shqyrtues shqyrtoi gjithashtu raportin gjyqtarit raportues dhe me këtë rast njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se nga viti 2004 deri më 3 janar 2018, parashtuesi i kërkesës dhe personi V. A. kanë jetuar së bashku në një bashkësi jashtëmartesore.
17. Më 19 janar 2018, V. A., shkaku i dhunës në familje, parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore, me të cilën kërkonte që asaj t'i miratoheshin masat mbrojtëse në mënyrë që të parandalohet abuzimi i saj i mëtejshëm fizik dhe psikologjik nga parashtuesi i kërkesës.
18. Më 23 janar 2018, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin C. nr. 151/18, me të cilin e miratoi kërkesën e V. A., si të bazuar. Me të njëjtin Aktvendim, Gjykata Themelore i ndaloi parashtuesit të kërkesës *“kryerjen e dhunës së mëtutjeshme psikologjike dhe fizike ndaj palës së mbrojtur, kryerjen apo kërcënimin e kryerjes së ndonjë vepre të re të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur, shqetësimin, fyerjen, përruljen, goditjen, kërcënimin, sulmin fizik apo seksual, përcjelljen, ndjekjen, dëmtimin ose kërcënimin për dëmtimin e pronës personale të palës së mbrojtur, përndjekjen apo bllokimin e lëvizjes së saj”*. Gjithashtu, Gjykata Themelore e shqiptoi masën mbrojtëse për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh dhe detyroi parashtuesin e kërkesës të

pranonte palën e mbrojtur në shtëpinë ku ata kishin jetuar së bashku deri më 3 janar 2018.

19. Gjykata Themelore arsyetoi shqiptimin e masës mbrojtëse si vijon: *“Gjykata, në bazë të provave dhe deklaratave, vërteton se kryerësi i dhunës në familje në këtë rast konkret ka kryer dhunë psikologjike dhe fizike në kuptimin e nenit 2, paragrafit 1, pika 1.2, ku ceket se përdorimi i dhunës psikologjike që kryhet ndaj anëtarëve të tjerë të familjes, duke përdorur forcë fizike dhe presion psikologjik, duke shkaktuar dhimbje fizike dhe vuajtje psikologjike të palës së mbrojtur, shkaktimin e ndjenjës së frikës, rrezikut personal dhe mohimin e dinjitetit, si dhe fyerjen, kërcënimin, sharjen dhe përsëritjen e vazhduar të këtyre veprimeve”.*
20. Më 23 janar 2019, personi V. A. parashtroi në Gjykatën Themelore kërkesë të re për vendosjen e një mase mbrojtëse të re, pasi që masa mbrojtëse e cila ishte vendosur me Aktvendimin C. nr. 151/18 kishte skaduar në 23 janar 2019.
21. Më 5 mars 2019, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin e ri C. nr. 532/19, me të cilin pranoi pjesërisht kërkesën e re për vendosjen e masës mbrojtëse me kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muaj.
22. Më 13 mars 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, C. nr. 532/19, për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 25 prill 2019, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin Ac. nr. 1803/19, me të cilin hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar, duke cekur se *“pretendimi i palës së mbrojtur në lidhje me mënyrën e vendosjes së gjykatës së shkallës së parë në shqiptimin e aktvendimit të kundërshtuar, respektivisht që Gjykata nuk e ka vërtetuar fare faktin nëse palët ndërgjyqëse janë në bashkësi jashtëmartesore apo kishin qenë në bashkësi jashtëmartesore, është i pabazuar”.*
24. Parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1803/19, për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, më konkretisht, Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (në tekstin e mëtejshmë: Ligji), sepse në rastin konkret nuk kishin ekzistuar kushtet ligjore për zbatimin e tij.
25. Më 10 korrik 2019, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin Rev. nr. 220/2019, me të cilin refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për revizion. Në arsyetimin e Aktvendimit të Gjykatës Supreme thuhet:

“Nga revizioni i të autorizuarit të palës përgjegjëse rrjedh se përmbajtja e revizionit është plotësisht e njëjtë me përmbajtjen e ankesës së parashtruar kundër Aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e të cilit, gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe të pranueshme edhe për Gjykatën e revizionit. Në këtë kuptim, janë kundërshtuar si të pabazuara pretendimet e revizionit për

shkelje materiale të dispozitave të procedurës kontestimore sipas nenit 182.1 në lidhje me nenin 204 të LPK-së, sipas të cilave gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë vlerësim dhe arsyetim të mjaftueshëm për pretendimet ankimore, edhe pse kjo duhej të bëhej sipas nenit 204 të LPK-së. Gjykata e revizionit vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë për faktin se gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar pretendimet e ankesës të cilat ishin me rëndësi vendimtare për nxjerrjen e vendimit të saj në përputhje të plotë me nenin 204 të LPK-së.

Gjykata e revizionit vlerëson se nuk ka shkelje substanciale të dispozitave procedurale të nenit 182.2, pika n, të LPK-së, për faktin se në aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të shkallës së parë, jepen arsye të mjaftueshme nga fakti përkatës për nxjerrjen e urdhrit për mbrojtje, të cilat janë të pranueshme edhe për Gjykatën.

Gjykata Supreme hedh poshtë si të pabazuara pretendimet e revizionit edhe për zbatimin e gabuar të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, sepse në rastin konkret, siç është cekur më lart, ekzistojnë të gjitha kushtet ligjore për shqiptimin e urdhrit për mbrojtje”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon “se me vendimet e Gjykatës Themelore, C. nr. 532/19 të 05.03.2019, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 1803/19 të 25.04.2019 dhe të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 220/2019 të 25.04.2019 i është shkelur e drejta e tij kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç parashikohet në dispozitat e nenit 31, paragrafi 2 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së”.
27. Parashtruesi ato pretendime i vë në lidhje me faktin se gjykatat e rregullta i kanë bazuar vendimet e tyre në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike në lidhje me çështjen e bashkësisë së tyre jashtëmartesore, sepse, sipas pretendimit të tij, “ai dhe personi V. A., nuk kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore ashtu siç parashikohet në nenin 2, paragrafi 1, të Ligjit 03/L-182, dhe si rezultat i kësaj, gjykatat kanë bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale”.
28. Parashtruesi i kërkesës pretendon më tej se aktvendimet e gjykatave të rregullta nuk ishin arsyetuar siç parashikohet në Ligjin e Procedurës Kontestimore, në të cilin përcaktohet qartë se çfarë duhet të përmbajë një vendim gjyqësor.
29. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pohon se, edhe nga aspekti ligjor, aktvendimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme nuk kanë arsye time, sepse ato kanë shqiptuar masën mbrojtëse, pa u përgjigjur fare në pretendimet e tij ankimore në ankesë si dhe në pretendimet në revizion. Nga këto mund të konkludohet se ai, si parashtrues i ankesës dhe revizionit, nuk ka marrë përgjigje adekuate për pretendimet e tij, pavarësisht nga fakti se ato ishin vendimtare për marrjen e një vendimi të drejtë dhe ligjor.

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, ekziston një numër i madh i rasteve kur mungesa e arsytimit të një vendimi gjyqësor është konsideruar si shkelje e së drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë sipas nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (për më shumë shikoni aktgjykimet në rastet: KI/135/14 nr. ref. AGJ.1887/16, i 8 shkurtit 2016; KI18/16, nr. ref. AGJ.968/16 i 15 korrikut 2016; KII38/15, nr. ref. AGJ.1177/17 i 20 dhjetorit 2017; KI97/16, nr. ref. AGJ. 1182/18 i 9 janarit 2018; KI69/16, nr. ref. AGJ: 1247/18, i 6 qershorit 2018; KI87/18, nr. ref. AGJ.1347/19 i 15 prillit 2019; KI.145/18, nr. ref. AGJ.1408/18, i 13 gushtit 2019; KII35/18, nr. ref. AGJ.1409/19 i 13 gushtit 2019, etj.)”.
31. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesën që të konstatojë se Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 220/2019, i 10 korrikut 2019, si dhe aktvendimet gjyqësore që i paraprinë atij, kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm sipas nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Komentet e pranuar nga V.A

32. Më datat 22 dhe 23 prill 2020, pala e interesuar V.A. parashtroi në Gjykatë komentet lidhur me rastin dhe një numër të caktuar të vendimeve gjyqësore duke përfshirë një numër të caktuar të vendimeve dhe dokumenteve gjyqësore që nuk janë objekt shqyrtimi në këtë Gjykatë. Andaj, Gjykata thekson se vendimet dhe dokumentet gjyqësore që janë dorëzuar nga pala e interesuar V.A dhe te cilat nuk janë objekt shqyrtimi në këtë rast, Gjykata nuk do t'i shqyrtoj.

Pranueshmëria e kërkesës

33. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

35. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kushteve të pranueshmërisë, siç janë përcaktuar me ligj. Në këtë kuptim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

36. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 220/2019, të 10 korrikut 2019, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.

37. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafin (2) të Rregullores së punës, që parasheh:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

38. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se nuk ka pasur gjykim të drejtë dhe të paanshëm në përputhje me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, sepse gjykatat kanë bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe me këtë nuk kanë arsyetuar vendimet e tyre në përputhje me parimet dhe principet e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

39. Në lidhje me këtë, Gjykata, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, mund t'i ndajë në dy kategori të pretendimeve, në: **i)** pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale; dhe **ii)** pretendimet në lidhje me vendimet e paarsyetuara

gjqësore. Gjykata po ashtu ka konsideruar komentet e paraqitura nga pala e interesuar. Në vijim, Gjykata do të përgjigjet në pretendimet kryesore të këtij rasti.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale

40. Sa i përket kategorisë së parë të pretendimeve, Gjykata vëren se pretendimi kryesor ankimor i parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me faktin se gjykatat kanë bërë vërtetim të gabuar të fakteve dhe gjatë asaj kanë nxjerrë përfundim që ai dhe personi V. A. kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore, për të cilën, sipas pohimeve të tij, nuk ka prova, dhe për këtë arsye nuk ka pasur bazë ligjore për shqiptimin e masës mbrojtëse.
41. Më konkretisht, në lidhje me pretendimin e parë, respektivisht pohimin në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale, Gjykata rikujton se gjithmonë ka theksuar se këto pretendime nuk janë në juridiksionin e Gjykatës dhe, për këtë arsye, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (shih, në lidhje me këtë, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; KI154/17 dhe 05/18, parashtruesit e kërkesës *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60; KI192/18, parashtrues i kërkesës *Kompania Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji elektrike, KEDS SH. A.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 gushtit 2019, paragrafi 49).
42. Përmes praktikës së saj gjyqësore, Gjykata vazhdimisht ka theksuar se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet në fakte dhe ligj që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës materiale dhe procedurale (shih rasti GJEDNJ, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 28; shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI70/11, parashtruesit e kërkesës: *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; KI154/17 dhe 05/18 parashtruesit *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 61; KI192/18, parashtrues i kërkesës *Kompania Kosovare për Distribuid dhe Furnizim me Energji elektrike, KEDS SH. A.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 gushtit 2019, paragrafi 50).
43. Gjykata ka për detyrë të shqyrtojë procedurat në tërësi, që në rastin konkret përfshin edhe aktvendimet e gjykatave të apelit (shih, ndër të tjera, Aktgjykimin e GJEDNJ-së në rastin *Helmers kundër Suedisë*, të 29 tetorit

1991, Seria A nr. 212, f. 15, para. 31). Për më tepër, nuk është në juridiksionin e GJEDNJ-së që në vend të vlerësimit të vetë të fakteve të marrë interpretimin e gjykatës vendase, dhe është rregull i përgjithshëm që gjykata vendase të vlerësojë provat që i parashtrohen asaj. Detyra e Gjykatës është të vërtetojë nëse procedura në tërësi ishte e drejtë, duke përfshirë mënyrën e paraqitjes së provave (shih, ndër të tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, parashtrës nr. 79/1991/331-404, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, paragrafi 34).

44. Duke iu referuar rastit konkret dhe kategorisë së parë të pretendimeve ankimore, Gjykata vëren se Gjykata Themelore, gjatë miratimit të kërkesës për caktimin e masës mbrojtëse për personin V. A., ka konstatuar se bashkësia 13 (trembëdhjetë) vjeçare, në të cilin kanë jetuar së bashku parashtruesi i kërkesës dhe personi V. A., i përmbushte të gjitha parakushtet për t'u cilësuar si bashkësi jashtëmartesore, që është në pajtim me nenin 2 të Ligjit nr. 03-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.
45. Gjykata vëren se dispozita e nenit 2, paragrafët 1.1.1 deri 1.1.7 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, rregullojnë çështjet e marrëdhënies familjare, ku ndër të tjera thuhet:

“1.1 Marrëdhënie familjare konsiderohen personat nëse:

[...]

1.1.4. bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë;”

46. Për më tepër, Gjykata gjithashtu vëren se, pasi përcaktoi çështjen e marrëdhënies familjare në të cilën kishin jetuar parashtruesi i kërkesës dhe personi V. A., Gjykata Themelore, duke pasur parasysh dëshmitarët, deklaratat dhe provat, ka arritur në përfundim se, sipas nenit 5 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, mund të vendoset masa mbrojtëse.

“Neni 5

Masa mbrojtëse e ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje

1. Masa mbrojtëse e ndalimit të afrimit viktimës së dhunës në familje si dhe vartësit të tij/saj dhe personave tjerë nëse është e nevojshme, mund t'i shqiptohet personit i cili ka kryer dhunë në familje, nëse ekziston rreziku i përsëritjes së dhunës në familje”.

47. Më tej, Gjykata vëren se pas skadimit të masës së parë mbrojtëse, personi V. A. ka parashtruar kërkesën e re në Gjykatën Themelore për shqiptimin e masës së re mbrojtëse kundër parashtruesit të kërkesës. Gjykata vëren se Gjykata Themelore, me aktvendimin e ri ka vazhduar masën mbrojtëse edhe për 12 muaj të tjerë, por aktvendimit të tillë i ka paraprirë vërtetimi i sërishëm i gjendjes faktike nga Gjykata Themelore. Me atë rast, *“gjykata ka paraqitur provat në kuptim të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje duke*

lexuar procesverbalin e policisë të datës 21.02.2019, duke lexuar aktvendimin C.nr. 151/18 të kësaj Gjykate, duke dëgjuar palën e mbrojtur dhe duke dëgjuar palën përgjegjëse”.

48. Gjykata konstaton se parashtruesi ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, në të cilën pretendon se Gjykata Themelore në aktvendimin e ri për shqiptimin e masës mbrojtëse nuk është marrë me vërtetimin dhe kualifikimin e marrëdhënies së tyre, dhe rrjedhimisht, nuk ka bazë ligjore për shqiptimin e një mase mbrojtëse të re.
49. Gjykata e Apelit, duke pasur parasysh këtë pretendim ankimor të parashtruesit të kërkesës, ka arritur në përfundim se sa i përket marrëdhënies së tyre, *“asgjë nuk ishte kontestuese, sepse edhe nga vetë deklarata e personit përgjegjës, është vërtetuar se ata kishin jetuar së bashku deri në shkurt 2018, prandaj edhe nuk kishte pasur nevojë që të vërtetohet ky fakt, kështu që kjo masë ishte shqiptuar që kryerësi i dhunës të mbahej larg nga viktimja deri në një distancë të caktuar, për të shmangur dhunën në të ardhmen dhe për të arritur qëllimin e masës, që është parandalimi i dhunës”.*
50. Më tej, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se Gjykata Supreme konstatoi se *“përmbajtja e revizionit është plotësisht e njëjtë me përmbajtjen e ankesës së parashtruar kundër Aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e të cilit, gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe të pranueshme edhe për Gjykatën e revizionit”.*
51. Për më tepër, Gjykata Supreme përkundër këtij fakti, përsëri mori në shqyrtim pretendimet ankimore të cilat kishin të bënin si me gjendjen familjare të parashtruesit të kërkesës dhe personit V. A. ashtu edhe me bazën ligjore për shqiptimin e masës mbrojtëse të re, me ç’rast konstatoi se *“pohimet e revizionit që pala përgjegjëse me palën e mbrojtur nuk kishin jetuar në bashkësi faktike jashtëmartesore ishin të pabazuara. Palët në procedurë, siç u përmend më lart, kanë jetuar një kohë në bashkësi faktike jashtëmartesore deri në fillim të vitit 2018, fakt që konfirmohet nga deklarata me shkrim e dhënë nën betim të Noteri I. A., ku vetë pala përgjegjëse e pohoi këtë fakt, duke deklaruar pa asnjë presion që prej 5 shkurtit 2018, nuk po jetonte në bashkësi jashtëmartesore me palën e mbrojtur këtu”.*
52. Në lidhje me këtë, Gjykata, në bazë të shkresave të lëndës dhe aktvendimeve të gjykatave të rregullta konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se gjykatat kanë bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale janë të pabazuara, që nënkupton se nuk ka shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me këto pretendime.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me vendimet e paarsyetuara gjyqësore

53. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës gjithashtu e lidhë shkeljen nga neni 31 të Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ-së me faktin se aktvendimet e Gjykatës së

Apelit dhe Gjykatës Supreme nuk kanë arsyetime. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë lejuar vendosjen e masës mbrojtëse të re, pa u përgjigjur në detaje në pretendimet ankimore në parashtrësat e tij të cilat ia ka dërguar Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme, të cilat, sipas pretendimit të tij, ishin të rëndësishme thelbësore për rezultatin e procedurës.

54. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës se vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta, përkatësisht aktvendimet nuk përmbajnë arsyetim për faktet vendimtare dhe arsyet të cilat ai i ka cekur si bazë në ankesë, si pranë Gjykatës së Apelit ashtu edhe në kërkesën për revizion, Gjykata Kushtetuese rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së nga e cila rezulton që gjykatat vendase janë të detyruara të arsyetojnë aktgjykimet e tyre pa pasur nevojë të japin përgjigje të hollësishme për secilin pretendim, por nëse parashtrësia është thelbësore për rezultatin e lëndës, gjykata në atë rast duhet t'i përkushtohet atyre veçmas në vendimin e saj. Prandaj, vendimi i gjykatës duhet të ketë arsyet në të cilat bazohet dhe duhet të ketë arsyetim, veçanërisht ndaj pretendimeve që janë thelbësore për rezultatin e procedurës. Përndryshe, mund të ketë shkelje të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Ruiz Tori kundër Spanjës*, të 9 dhjetorit 1994, Seria A, numër 303-A, paragrafi 29; shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese: nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61).
55. Gjykata vëren gjithashtu se vendimet përfundimtare të gjykatave të apelit nuk kanë nevojë për arsyetime shteruese, por arsyetime në lidhje me pretendimet përkatëse ankimore, të cilat janë vlerësuar si të tilla (shih, ndër të tjera, rasti i Gjykatës Kushtetuese KI197/18, *Ramadan Bislimi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2019).
56. Duke iu rikthyer pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe arsyetimit të gjykatave të rregullta, Gjykata vëren se, në kundërshtim me pretendimet në kërkesë, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme iu përgjigjën çdo pretendimi ankimor, përkatësisht të revizionit që parashtruesi i kërkesës e konsideronte thelbësor dhe të rëndësishëm për marrjen e vendimit dhe se gjykatat nga pikëpamja e tyre kanë dhënë arsye të vlefshme, të qarta dhe logjike në pajtim me kërkesat e nenit 6, paragrafi 1 të KEDNJ-së.
57. Gjykata thekson veçanërisht se, Gjykata Supreme, përkundër konstatimit që parashtruesi i kërkesës përsëri ka paraqitur në procedurën e revizionit të njëjtat pretendime ankimore të cilat i kishte parashtruar edhe para Gjykatës së Apelit, përsëri është marrë me to në aktvendimin e saj, pasi që parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike ka cekur se mu ai pretendim ishte thelbësor dhe vendimtar për rezultatin e procedurës. Duke vepruar kështu, sipas mendimit të gjykatës, Gjykata Supreme ka zbatuar parimin e gjykimit të drejtë siç përcaktohet në Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Ruiz Tori kundër Spanjës*.
58. Gjykata gjithashtu thekson se ka vërejtur se parashtruesi në kërkesë pretendon që Gjykata Kushtetuese, në një numër të caktuar të aktgjykimeve të saj, ka gjetur shkelje të të drejtave dhe lirive të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës

dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi gjykatat nuk i kanë arsyetuar vendimet e tyre në përputhje me parimet e së drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor.

59. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se është fakt i pakontestuar që Gjykata në një numër të caktuar të vendimeve të saj, ka gjetur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, të cilat i ka ndërlidhur me vendime gjyqësore të paarsyetuara, por që Gjykata gjithashtu dëshiron të theksojë se secili rast para Gjykatës Kushtetuese ka veçantitë dhe specifikat e veta, të cilat mund të jenë arsye e mjaftueshme që Gjykata të gjejë shkelje specifike. Megjithatë, çdo referencë në aktgjykime të tilla dhe krahasimi i rastit të tij me raste të tilla nuk është arsye dhe bazë e mjaftueshme që Gjykata, edhe në rastin konkret, të gjejë shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë.
60. Prandaj, bazuar në të gjitha të cekurat më lart, Gjykata konsideron se gjykatat e rregullta kanë respektuar detyrimin e tyre sipas nenit 31 të Kushtetutës si dhe nenit 6 të KEDNJ-së, lidhur me vendimin e arsyetuar, ku si rrjedhojë janë të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës se në vendimet e kontestuara është shkelur e drejta për gjykim të drejtë në atë segment.
61. Gjykata konstaton se asgjë në rastin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës nuk tregon se procedura para Gjykatave Themelore, të Apelit dhe Supreme ishte e padrejtë ose arbitrare për të bindur Gjykatën Kushtetuese se parashtruesit të kërkesës i janë mohuar çfarëdo garanci procedurale, gjë që do të sillte deri te shkelja e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës, përkatësisht nenin 6 të KEDNJ-së.
62. Gjykata thekson që është obligim i parashtruesit të kërkesës që t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë provë *prima facie* që tregon shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, të 5 dhjetorit 2013).
63. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 korrik 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi